

Vendim nr. 120 datë 31.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 31.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

- KËRKUES:** MANUEL AUGUSTO BLACKER-MILLER, përfaqësuar nga avokate Manushaqe Zhulali, me prokurë.
- OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1906, datë 21.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 4, pika 1, 5, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pika 3, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Manuel Augusto Blacker-Miller (*kërkuesi*) është shtetas peruan. Ai ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë më 10.09.2012 dhe prej asaj date ai është me vendbanim në Shqipëri. Me vendimin nr. 7, datë 15.07.2013, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme i ka dhënë atij të drejtën për azil në Republikën e Shqipërisë.

2. Në datën 24.02.2014 shtetasi A.Sh. ka paraqitur kallëzim penal kundër kërkuesit për veprën penale të mashtrimit. Në vijim, ndaj kërkuesit është regjistruar një procedim penal dhe ai më pas është akuzuar për veprën penale “Mashtrimi” në rrethana cilësuese (me pasoja të rënda), të parashikuar nga neni 143, paragrafi 2, i Kodit Penal (KP), duke u caktuar ndaj tij masa e sigurimit personal e ndalimit për t’u larguar jashtë shtetit. Në përfundim të hetimeve paraprake çështja penale është dërguar për gjykim.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1521, datë 23.05.2017, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi 3, i KP-së, i ndryshuar me ligjin nr. 36/2017 dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim. Gjykata ka arsyetuar se fakti penal i provuar përmbante elementet e veprës penale “Mashtrimi” në rrethana cilësuese (me pasoja të rënda), që aktualisht parashikohej nga neni 143, paragrafi 3, i KP-së, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 36/2017, dispozitë e cila është më favorizuese për të pandehurin (kërkuesin) në raport me dispozitën që parashikonte këtë veprë penale në kohën e kryerjes së saj (neni 143, paragrafi 2, i KP-së), ndaj është rasti për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2349, datë 07.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas gjykatës së apelit, në ankimin e të pandehurit (kërkuesit) nuk parashtrohej asnjë shkak ligjor për cenimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ku në të njëjtën linjë me këtë të fundit ka vlerësuar se vendimi ishte i drejtë dhe i bazuar në prova. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuesi ka ushtruar rekurs.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1906, datë 21.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se shkaqet e ngritura në rekurs për zbatimin e gabuar të dispozitave materiale dhe procedurale penale nga gjykatat më të ulëta ishin të pabazuara. Këto shkaqe janë parashtruar edhe përpara gjykatës së apelit, e cila i ka shqyrtuar dhe dhënë përgjigje.

6. Në datën 19.03.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000 është regjistruar në datën 03.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës për t'u mbrojtur të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe me të drejtën e zgjedhjes së avokatit*, pasi gjykimi i çështjes në shkallë të parë në shumicën e seancave është bërë në mungesë të kërkuesit, ndërkohë që mungojnë aktet e njoftimit (letërthirrjet) dhe konfirmimi i tij për marrjen dijeni për gjykimin, duke u shkelur në këtë mënyrë rregullat për njoftimin e të pandehurit të lirë sipas neneve 140 e vijues, 340 dhe 351, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ndërsa kërkuesi ka qenë pa masë sigurimi. Gjithashtu, në seancën e datës 19.04.2017 gjykata e shkallës së parë ka zëvendësuar avokaten e zgjedhur nga kërkuesi me një avokate të caktuar kryesisht edhe pse ajo kishte arsye objektive për mosparaqitjen në seancë, duke mos marrë kështu parasysh gjykata vullnetin e tij. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë i ka hequr kërkuesit të drejtën dhe mundësinë për të qenë i pranishëm në gjykim, të drejtën për t'u mbrojtur nga avokati i zgjedhur prej tij, të drejtën për të kërkuar gjykim të shkurtuar, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave që ai do t'i çmonte të domosdoshme etj. Po kështu, kërkuesit nuk i është njoftuar nëpërmjet shpalljes përbërja e trupit gjykues, duke mos pasur mundësi për t'u shprehur në lidhje me të.

7.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i shkallës së parë nuk plotëson kërkesat e nenit 383, pika 1, shkronja "ç", të *KPP*-së në rrethanat kur atij i mungon analiza ligjore e provave. Ajo gjykatë ka cituar thëniet e kallëzuesve, por nuk ka analizuar, vlerësuar dhe çmuar provat të cilat mund të hidhnin dritë dhe të fajësonin kërkuesin për veprën penale për të cilën akuzohej, për të përcaktuar veprimet konkrete të paligjshme të tij, kohën, vendin dhe

rrethanat e kryerjes së tyre dhe se ku konsistonte shpërdorimi i besimit dhe realizimi nga ai i gënjeshtërs, përveçse edhe masën e dëmit, ndërsa ky i fundit nuk është përcaktuar as në dispozitivin e vendimit. Për sa i përket zgjidhjes së çështjes në themel, në rastin konkret jemi përpara një fakti civil, që ligjërisht mund dhe duhet të zgjidhet me padi civile, pasi dëmi i pretenduar nga kallëzuesit është shkaktuar në kushtet e një marrëdhënieje biznesi dhe huaje mes atyre dhe shoqërisë tregtare X, në të cilën kërkuesi ka qenë administrator dhe ortak i saj, marrëdhënie e cila është formalizuar edhe me kontrata që janë ende në fuqi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

9. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi gjyqësor i kundërshtuar prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur të lidhur me të drejtën e zgjedhjes së avokatit, me argumentin se gjykata e shkallës së parë, në seancën e datës 19.04.2017, ka zëvendësuar avokaten e zgjedhur nga ai, e cila kishte arsye objektive për mosparaqitjen në seancë me një avokate të caktuar kryesisht, duke mos marrë kështu parasysh vullnetin e tij. Po kështu, sipas kërkuesit, në gjykimin e çështjes në shkallë të parë nuk ishte shpallur përbërja e trupit gjykues, duke mos pasur kështu mundësinë për t’u shprehur për këtë aspekt të procesit. Vërehet se një pretendim i tillë është ngritur për herë të parë vetëm në ankimin kushtetues individual. Nisur nga kjo, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

13. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur të lidhur me të drejtën për t’u njoftuar, Kolegji vëren se një pretendim i tillë është ngritur qoftë në ankimin kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, qoftë edhe në rekursin kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke u plotësuar kështu kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion. Ky kriter plotësohet edhe për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këto dy pretendime kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

14. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 21.11.2023, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 19.03.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit, kërkuesi ka pretenduar zbatimin e gabuar të ligjit penal nga gjykatat për zgjidhjen e çështjes në themel, pasi, sipas tij, në rastin konkret, është përpara një fakti civil, që ligjërisht mund dhe duhet të zgjidhet me padi civile. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*), për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për këtë pretendim.

16. Kërkuesi ka pretenduar se edhe nga procesi gjyqësor i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u mbrojtur të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Kolegji vëren se në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual këto pretendime adresohen ndaj procesit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që në objektin e tij kundërshtohet vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë. Pavarësisht kësaj, duke qenë se thelbi i ankimit adresohet për procesin gjyqësor në tërësi, pretendimet e ngritura do të trajtohen në këtë kontekst, ndaj, duke vlerësuar se ato *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës, do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar

17. Kërkuesi ka pretenduar se gjykimi i çështjes në shkallë të parë në shumicën e seancave është bërë në mungesë të tij, ndërkohë që mungonin aktet e njoftimit (letërthirrjet) dhe konfirmimi i tij për marrjen dijeni për gjykimin, duke u shkelur në këtë mënyrë rregullat për njoftimin e të pandehurit të lirë sipas neneve 140 e vijues, 340 dhe 351, pikat 1 dhe 2, të KPP-së, ndërsa kërkuesi ka qenë pa masë sigurimi. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë i ka hequr kërkuesit të drejtën dhe mundësinë për të qenë i pranishëm në gjykim, të drejtën për të kërkuar gjykim të shkurtuar, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave që ai do t'i çmonte të domosdoshme etj.

18. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të

njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare Ajo u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 27.01.2017; nr. 34, datë 25.07.2011; nr. 34 datë 03.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar si elemente përbërëse të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën e mbrojtjes, si dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Këto të drejta, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata është shprehur se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë, në vetvete, elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimin nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke i rikthyer rastit në shqyrtim, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për efekt të këtij shqyrtimi, Kolegji konstaton se seancat e para gjyqësore nuk janë realizuar për shkak të dështimit të njoftimit të të pandehurit (kërkuesit) në adresën e deklaruar prej tij. Në vijim, ndërsa është tentuar njoftimi i tij në adresa alternative, rezulton që kërkuesi të jetë vënë në dijeni për procesin gjyqësor, duke u paraqitur rregullisht në gjykim. Ai ka zgjedhur të mbrohet me një avokat, ndërkohë që procesi është zhvilluar edhe në prani të një përkthyesi të gjuhës angleze, për të cilën ai ka deklaruar se e njihete. Procesi gjyqësor ka vijuar përgjatë shumë seancave gjyqësore, të shtrira në një periudhë kohore prej më shumë se 2 vjetësh, shumica nga të cilat kanë dështuar për arsye të ndryshme, si, mosparaqitja e prokurorit, mosparaqitja e mbrojtësit të zgjedhur,

mosformimi i trupit gjykues, mosparaqitja e përkthyesit, mosparaqitja e dëshmitarëve etj., ndërkohë që i pandehuri (kërkuesi) ka qenë rregullisht i pranishëm në gjykim. Në veçanti, në seancat gjyqësore të zhvilluara realisht, ku palët kanë parashtruar kërkesa dhe qëndrimin e tyre, si dhe ku gjykata ka marrë provat e kërkuara nga ato, kërkuesi ka qenë i pranishëm bashkë me mbrojtësin e zgjedhur, ndërsa ata kanë shfrytëzuar mundësinë për të paraqitur kërkesa procedurale për të kundërshtuar provat e kërkuara nga prokurori, për të kërkuar prova që kanë çmuar të nevojshme, për të pyetur dëshmitarët e akuzës dhe për të kundërshtuar dëshminë e tyre, për të bërë deklaratime dhe për të paraqitur qëndrimin në lidhje me akuzën.

21. Pretendimin për mungesën e njoftimit dhe për pasojë shkeljen e së drejtës së mbrojtjes kërkuesi e ka ngritur edhe në ankimin në gjykatën e apelit, e cila e ka gjetur atë të pabazuar. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë e ka gjetur të pabazuar këtë pretendim të ngritur në rekursin e kërkuesit, me arsyetimin se nuk konstatonte mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural nga gjykatat, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, të tillë që të ndikojë në dhënien e vendimit, në dëm të të gjykuarit.

22. Për sa më lart, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i zhvilluar në shkallë të parë nuk duket që të ketë parregullsi në drejtim të njoftimit të kërkuesit, pjesëmarrjes së tij në gjykim dhe realizimin nga ai të së drejtës për t'u mbrojtur. Ky aspekt i procesit i është nënshtruar kontrollit rishikues nga gjykatat më të larta, duke mos gjetur shkelje të të drejtave të tij. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të arsytimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi ig shkallës së parë nuk plotësonte kërkesat e nenit 383, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së në rrethanat kur atij i mungonte analiza ligjore e provave. Sipas kërkuesit, ajo gjykatë ka cituar thënie të kallëzuesve, por nuk ka analizuar, vlerësuar dhe çmuar provat të cilat mund të hidhnin dritë dhe ta fajësonin atë për veprën penale që akuzohej, për të përcaktuar veprimet konkrete të paligjshme të tij, kohën, vendin dhe rrethanat e kryerjes së tyre dhe se ku konsistonte shpërdorimi i besimit dhe realizimi nga ai i gënjeshtërs, përveçse edhe masën e dëmit, ndërsa ky i fundit nuk është përcaktuar as në dispozitivin e vendimit.

24. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr.18, datë 15.03.2016; nr. 8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në lidhje me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata është shprehur se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, zbatimi i standardit të arsyetimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre.

26. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se, për sa i përket faktit penal, gjykata e shkallës së parë ka pranuar se në datën 14.09.2012 kërkuesi ka blerë nga shtetasi italian G.A. 80% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare X, duke u zgjedhur edhe si administrator i saj. Ortak i kësaj shoqërie ka qenë edhe shoqëria tregtare Y, ortakë të së cilës, nga ana tjetër, kanë qenë shtetasi italian G.A. dhe shtetasi shqiptar A.Sh. Kjo e fundit ka pasur një projekt për përpunimin e

mbetjeve urbane në një qytet të Shqipërisë, për realizimin e të cilit ka pasur nevojë edhe për investitorë të tjerë. Pasi janë njohur me kërkuësin, ky i fundit u ka ofruar atyre t'i ndihmojë financiarisht nëpërmjet shoqërisë X. Megjithatë, përgjatë një periudhe 1-vjeçare kërkuësi jo vetëm që nuk ka financuar shumën e premtuar për investim, por me arsyetime dhe justifikime të ndryshme, në disa raste, i ka marrë shtetasit A.Sh. një shumë që kap vlerën e përgjithshme prej 150 000 eurosh, nga të cilat 100 000 euro janë dhënë përmes shoqërisë Y, kurse 50 000 euro i janë dhënë *cash* nga vetë ai shtetas. Këtë shumë, pavarësisht kërkesave të shtetasit A.Sh., kërkuësi nuk ia ka kthyer.

27. Po kështu, gjykata e shkallës së parë ka pranuar se po gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet shtetasit A.Sh., kërkuësi ka hyrë në kontakt edhe me shtetasin shqiptar I.F., i cili është administrator i një shoqërie tregtare me objekt veprimtarie në fushën e hidrokarbureve. Këta të fundit kanë rënë dakord të themelojnë një shoqëri për shitjen e hidrokarbureve me shumicë e pakicë në Shqipëri dhe Ballkan, nëpërmjet një investimi në masën 50% secili. Për këtë, në datën 24.05.2023 ata kanë nënshkruar një marrëveshje noteriale *joint venture* për importin e naftës në Shqipëri dhe në shtetet e tjera të Ballkanit. Sipas marrëveshjes, kërkuësi, në cilësinë e përfaqësuesit dhe të administratorit të shoqërisë X, ka marrë përsipër të investojë shumën 20 000 000 euro për shoqërinë e shtetasit I.F. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, kërkuësi i ka kërkuar këtij të fundit shumën prej 21 000 eurosh me pretendimin për të mundësuar transferimin e shumës 20 000 000 euro në Shqipëri për fondin e shoqërisë X. Shtetasi I.F. ka pranuar duke i transferuar kërkuësit, nëpërmjet bankës, në datën 08.03.2013, shumën 20 000 euro. Megjithatë, kërkuësi nuk e ka respektuar marrëveshjen, ndaj, në vijim, në datën 09.09.2013 palët kanë hartuar një marrëveshje të dytë me të cilën kanë rënë dakord për pushimin e detyrimeve që rridhnin nga marrëveshja e parë, por duke pranuar detyrimin e kërkuësit, për pagimin, kthimin e shumës 21 000 euro. Edhe këtë marrëveshje kërkuësi nuk e ka respektuar.

28. Në vijim, Kolegji, për ankimin e kërkuësit, vëren se gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë në të njëjtën linjë arsyetimi. Në lidhje me pretendimin e kërkuësit se në rastin konkret janë para një marrëdhënieje juridikocivile, gjykata e apelit ka arsyetuar se për të rënë në penalitetet e nenit 143 të KP-së, mjafton të vërtetohen elementet e veprës penale në veprimet e të pandehurit, duke mos qenë kusht i domosdoshëm ekzistenca e një marrëdhënieje juridikokontraktore mes palëve dhe as lloji specifik i marrëdhënies kontraktore, por mjafton që veprimtaria e të pandehurit të dëmtojë interesat pasurorë të palës së dëmtuar, duke

vjedhur, nëpërmjet gënjeshtërs, pasurinë e luajtshme të saj në vlerë monetare, si dhe duke i shkaktuar një dëm të rëndë financiar e ekonomik.

29. Për rekursin e kërkuarit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se shkaqet e ngritura në rekurs ishin të pabazuara. Sipas atij kolegji, ato shkaqe ishin parashtruar edhe përpara gjykatës së apelit, e cila i ka shqyrtuar dhe u ka dhënë përgjigje, ndërkohë që vendimi i saj ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit material penal (neni 143 i KP-së) dhe ligjit procedural penal (nenet 152 dhe 388 të KPP-së). Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit, si gjykatë fakti dhe ligji, ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të të pandehurit/apelues në atë proces penal, ndërsa nuk konstatohej mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, të tillë që të ndikojë në dhënien e vendimit, në dëm të të gjykuarit, si dhe nuk rezultonte që vendimi i ankimuar të binte në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, si i tillë, nuk ishte i cenueshëm ligjërisht. Për sa u përket pretendimeve në rekurs për mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe provave, ai kolegji ka theksuar se një çështje e tillë del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

30. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat gjykata është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Gjykata ka vlerësuar edhe provat që kërkuari pretendon dhe, në analizë të të gjitha provave të administruara në gjykim, ajo gjykatë ka arritur në përfundime për ekzistencën e faktit penal ku, mbi këtë bazë, ka zbatuar ndaj kërkuarit ligjin penal. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe gjykata e apelit, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, me arsyetimin se vendimi i gjykatës së apelit ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit material dhe atij procedural penal, duke konstatuar se shkaqet e rekursit ishin të njëjta me ato të parashtruara në ankimin përpara gjykatës së apelit, të cilat janë marrë në shqyrtim dhe u është dhënë përgjigje nga ajo gjykatë. Në këtë mënyrë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk duket të mos kenë përmbushur standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor, për rrjedhojë Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

31. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.